



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 297, Datë 30.12.2024

MBI

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS SHQIPTARE TË FURNIZUESVE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE (AAES) PËR DISA NDRYSHIME DHE KUFIZIME NË
ZBATIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 186, DATË 06.06.2023**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 33, pika 1, gërma “a”, 105 dhe 144 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe neneve 15 dhe 16 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Konsumatore me nr. 2447/6 prot., datë 26.12.2024 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 186, datë 06.06.2023”,

Konstatoi se:

- Shoqata AAES me anë të shkresës me nr. 2111 prot., datë 21.11.2024, protokolluar në ERE me nr. 2447 prot., datë 25.11.2024, paraqiti kërkesën për zgjatjen e afatit të derogimit të pjesshëm të dispozitave të “Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.02.2022, i ndryshuar me vendimin nr.186, datë 06.06.2023 dhe së fundmi me vendimin nr. 44, datë 29.03.2024 deri më datë 31.12.2025.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 186, datë 06.06.2023, vendosi të përjashtojë të gjithë Furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të lirë nga detyrimi për implementimin e masave të parashikuara në nenin 1.2 gërmat “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “j”, si dhe në nenet 2.1, 2.2 , 4.1 dhe 4.2 të “Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.02.2022., deri më 31.12.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës së shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), dhe vlerësimit të kushteve të operimit të furnizuesve në tregun e lirë, si dhe nivelit të hapjes dhe liberalizimit të tij, ERE, me vendimin nr. 44, datë 29.03.2024, vendosi ndër të tjera që: *Furnizuesit që ushtrojnë*

aktivitetin e furnizimit në treg të liberalizuar, të cilët furnizojnë njëkohësisht më pak se 100 konsumatorë, përjashtohen deri në datë 31.12.2024 nga detyrimi për implementimin e masave të parashikuara në nenin 1.2 gërmat “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “j”, në nenet 2.1 dhe 2.2 si dhe në nenet 4.1 dhe 4.2.

- Sipas të dhënave të raportuara nga Operatorët e Rrjetit të Energjisë Elektrike, rezulton se, për periudhën 1 janar 2024 deri në tetor 2024, numri i klientëve përfitues nga shërbimi i furnizimit në treg të lirë është **2.203** klientë, nga të cilët 15 klientë janë të lidhur në Sistemin e Transmetimit dhe 2.188 klientë janë të lidhur në Sistemin e Shpërndarjes (në rrjetin 35/20 kV), ku 93 klientë janë të lidhur në rrjetin 35 kV dhe 2095 në rrjetin 20 kV.
- Sipas të dhënave të përpunuara nga ERE mbi raportimet e të licencuarve për zbatimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit, rezulton se gjatë 3 mujorit të dytë të vitit 2024, nga 30 furnizues të licencuar, vetëm 8 prej tyre kanë ushtruar aktivitet në tregun e liberalizuar.
- Gjatë vitit 2024 është vërejtur një numër i vogël ankesash nga klientët e furnizuar në tregun e lirë. Më datë 19.12.2024, ERE organizoi një seancë dëgjimore, të thirrur me urdhrin e Kryetarit të ERE-së, datë 11.12.2024. Në këtë seancë morën pjesë përfaqësues të Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) dhe shoqërive GEN-I sh.p.k., FTL sh.a., Dragobia Energy Trade sh.p.k., KESH sh.a., Ener Trade sh.p.k., dhe NRG Energy sh.p.k. Diskutimet u përqendruan në shtyrjen e afatit për zbatimin e dispozitave ligjore të Rregullores mbi masat për të licencuarit në aktivitetin e furnizimit, me fokus në përmbushjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit nga ERE. Gjatë seancës, palët u dakordësuan që furnizuesit e energjisë elektrike që furnizojnë më pak se 100 konsumatorë njëkohësisht të përjashtohen nga detyrimi për zbatimin e masave të përcaktuara në nenin 1.2, gërmat “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “j”, si dhe në nenet 2.1, 2.2, 4.1 dhe 4.2 të “*Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit*” nga ERE. Në rast të kundërt, këto dispozita do të jenë të zbatueshme. Furnizuesit janë të detyruar të njoftojnë ERE-n sa herë që arrijnë kriterin e furnizimit të 100 konsumatorëve njëkohësisht dhe të dokumentojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në dispozitat e deroguar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e pjesshëm të kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të bordit të ERE-s nr.186, datë 06.06.2023.
2. Pika 2 e dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 186, datë 06.06.2023 ndryshon dhe bëhet:
 - *Çdo furnizues që operon në tregun e liberalizuar dhe furnizon njëkohësisht të paktën 100 konsumatorë është i detyruar të zbatojë masat e përcaktuara në nenin 1.2, gërmat “a”, “b”, “d”, “e”, “f”, “g” dhe “j”, si dhe në nenet 2.1, 2.2, 4.1 dhe 4.2 të “Rregullores mbi*

masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”

3. Të gjithë furnizuesit janë të detyruar të njoftojnë ERE-n sa herë që arrijnë kriterin e furnizimit të 100 konsumatorëve njëkohësisht dhe të dokumentojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në dispozitat e deroguara, brenda 10 ditëve nga plotësimi i këtyre kushteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI